



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 27.11.2012
Nr. 0204-1193

PËR: Burim Berisha, Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës
Jakup Tërnavë, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIM TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVË, Nr.161, të pranuar me datën 7.11.2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe afatin ligjor të përcaktuar në nenin 83.3, të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (shtojca XII), pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit Nr.161 të datës 17.08.2012 të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm afatshkurt për dhjetë (10) vite me qera të dy objekteve me destinim për çerdhe të fëmijëve, me çmim prej 222.00€ në muaj për secilin objekt, operatorit ekonomik "Beni Dona Plast" nga Prishtina, **Konstaton se:**

- Vendimi Nr.161, për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm afatshkurt për dhjetë (10) vite me qera të dy objekteve me destinim për çerdhe të fëmijëve, është në kundërshtim me nenin 5 dhe 7 të Ligjit nr. 03/L-226 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 4, 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.2012/02 për Zbatimin e Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmë të nevojshme për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve;
Zyra Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 27.11.2012
br. 0204-1193

Za: Burim Berisha, Gradonačelnik opštine Kosovo Polje
Jakup Tërnavë, predsedavajući skupštine opštine Kosovo Polje

Predmet: Zahtev o razmatranju procenjivanja zakonitosti odluke opštine Kosovo Polje, br.161, primljeno dana 7.11.2012

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave prema nadležnosti i zakonskom mandatu definisano članom 83.3, zakona br. 03/z 040 o lokalnoj samoupravi, uredbe br. 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarstva (dodatak XII), nakon razmatranja zakonitosti odluke br.161 dana 17.08.2012 skupštine opštine Kosovo Polje za davanje na kratkoročno, privremeno korišćenje za deset (10) godina zakupa oba objekata namenjenih za obdanište, po ceni od 222,00 € mesečno, za svaki objekat, ekonomskom operatoru "Beni Dona Plast" iz Prištine, smatra da:

Odluka br.161, za davanje na kratkoročno privremeno, korišćenje za deset (10) godina zakupa oba objekata namenjenih za obdanište, je u suprotnosti sa članom 5 i 7 zakona br. 03/z-226 za davanje na korist i razmenu nepokretne opštinske imovine kao i član 4, 5 i 6 administrativnog uputstva br.2012/02 za sprovođenje zakona o davanju na korist i razmenu nepokretne opštinske imovine.

MALS, je posvećeno da pruža potrebnu pomoć i podršku sa ciljem potpunog sprovođenja ovih dužnosti koje proističu od strane sprovodljivog zakonodavstva o lokalnoj samoupravi u Republici Kosovo.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Direktorima odeljena;
Arkivi MALS-a



164 06 11 012
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 06.11.2012

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.10.2012, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 149, të datës 19.10.2012, paraqitur nga Komisioni Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të dy Çerdheve të Fëmijëve në fshatrat: Bardh i Madh dhe Miradi e Poshtme në Komunën e Fushë-Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 5, pika (2), të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226 (Gazeta Zyrtare Nr. 89/2010), nenin 14.2, nenin 17, shkronja (s) dhe nenin 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 3.2, nenin 12.1 shkronja (n) dhe nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

- I. Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm afatshkurtër për dhjetë vite me qera të dy objekteve me destinim për Çerdhe të Fëmijëve, me çmim prej 222.00€ në muaj për secilin objekt, operatorit ekonomik 'Beni Dona Plast' nga Prishtina në fshatrat:
 - Bardh i Madh, objekti në sipërfaqe prej 158,32 m², Ngastra Kadastrale Nr. 00815-0, në vendin e quajtur 'Selo Selo', e evidentuar në Fletën Poseduese Nr. UL-72514010-00175 në Zonën Kadastrale Bardh i Madh dhe
 - Miradi e Poshtme, objekti në sipërfaqe prej 158,32 m², Ngastra Kadastrale Nr. 00196-1, në vendin e quajtur 'Livade Pashnjak', e evidentuar në Fletën Poseduese Nr. UL-72514027-00149 në Zonën Kadastrale Miradi e Poshtme.
- II. Është në kompetencë të Drejtorisë për Arsim dhe Zyrës së Prokurimit, caktimi i të drejtave dhe detyrimeve në kontratën e qerasë për Komunën e Fushë-Kosovës dhe operatorit ekonomik 'Beni Dona Plast' nga Prishtina, konform dispozitave ligjore të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226 dhe Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042.
- III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për Arsim, Zyrës së Prokurimit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

